

Ndërveprimet

Pyetja 1

Kur njëri nga llojet përfiton, kurse tjetri dëmtohet kemi të bëjmë me:

- A) simbiozë
- B) komensializmi
- C) mutualizëm
- D) parazitizëm

Pyetja 2

Melanizmi industrial është një shembull i:

- A) përzgjedhjes së qëndrueshme
- B) përzgjedhjes së drejtuar
- C) përzgjedhjes së ndërprerë
- D) përshtatjes

Pyetja 3

Bashkëjetesa e dy organizmave të llojeve të ndryshëm, nga e cila përfiton njëri prej të dyve, pa e dëmtuar organizmin tjetër quhet:

- A) simbiozë
- B) komensializmi
- C) mutualizëm
- D) parazitizëm

Pyetja 4

Tërësia e ndërveprimit ndërmjet organizmave të një komuniteti dhe mjedisit përreth quhet:

- A) ndërveprim intraspecifik
- B) ndërveprim interspecifik
- C) ekosistem
- D) nish ekologjik

Pyetja 5

Burimi i energjisë në një ekosistem është:

- A) ATP-ja
- B) dielli
- C) glukoza
- D) bari

Pyetja 6

Cili nga përkufizimet e mëposhtme i referohet nishit?

- A) Tërësia e faktorëve mjedisorë që përcaktojnë vendin që zë organizmi
- B) Rrjetat ushqimore në një ekosistem
- C) Vendin ku jeton një organizëm i caktuar
- D) Roli që luan një lloj në një ekosistem

Pyetja 7


Diversiteti biologjik përfshin:

- A) diversitetin e llojeve, diversitetin e ekosistemeve dhe mjedisin
- B) diversitetin e llojeve, diversitetin gjenetik dhe diversitetin e ekosistemeve
- C) vetëm diversitetin brenda llojeve të ndryshme të një habitati
- D) variacionin dhe ndryshueshmërinë brenda individëve të të njëjtit lloj

Pyetja 8

Disa nxënës nëpërmjet kuadrateve provë hulumtuan shpeshinë e bimëve në një ekosistem. Ata përdorën kuadrate me brinjë 10, 25, 50, 75 dhe 100cm dhe shënuan se sa bimë përfshiheshin në to. Ata i përsëritën matjet e tyre dhe llogaritën numrin mesatar të bimëve për secilin kuadrat. Rezultatet jepen në grafik. Numri i bimëve në kuadratin me sipërfaqe $0.25m^2$ është:

- A) 2
- B) 4
- C) 6
- D) 7



Pyetja 9

Gjatë studimit të anemonës së kuqe, në bregdetin shkëmbor të Zelandës së Re, disa studiues përdorën kuadrate me sipërfaqe $0.5m^2$. Rezultatet e tyre jepen në tabelë. Sa është dendësia në m^2 e anemonit të kuq në zonën në studim?

Kuadrati	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Numri i anemonave të kuqe	1	6	2	1	2	3	5	2	2	1

- A) 5
- B) 15
- C) 25
- D) 50

Pyetja 10

Në një studim u vëzhgua rritja e bimës *Viola tricolor* në një lëndinë. Në zonën në studim u vendosën në mënyrë rastësore nga 10 kuadrate me brinjë 100cm. Në secilin kuadrat u krye numërimi i bimëve *Viola tricolor*. Rezultatet paraqiten në tabelë.

Kuadrati	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Numri i lule vjollcë	0	0	4	3	0	1	2	4	0	3

Sa është frekuenca e llojit në zonën në studim?

- A) 1.7
- B) 17
- C) 30%
- D) 60%